



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.110/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore, Anita Peci duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, për shkak të vendosjes së posterëve në shtylla elektrike për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 03.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 1700 (njëmijë e shtatëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 02.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 30.09.2017, aktivistët e tyre kanë vërejtur se në fshatin Bregu i Zi të Komunës së Lipjanit në shtylla elektrike ishin vendosur poster të kandidatit për Kryetar të Komunës së Lipjanit nga radhët e LDK-së.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 pika b), të LPZ-së, të dispozitës së nenit 4.1 pika b të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkëngjitur dy (2) fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 03.10.2017 Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e konsideron të pabazë ankesën për faktin se shtylla në fjalë zakonisht shfrytëzohet për njoftime të tilla dhe se ai poster është vendosur përkohësisht në atë fshat ku po mbahej një takim me qytetarët. Megjithatë pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, ka ndërmarrur masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur dy fotografi nga vendi ku është larguar posteri.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografit e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterët e kandidatit për Kryetar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik LDK, janë vendosur në shtylla elektrike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkëlur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që poster të kandidatit për Kryetar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga subjekti politik LDK, janë vendosur në objekte publike, përkatësisht në shtylla elektrike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politikë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti poster të kandidatëve të këtij subjekti politik janë vendosur në hapësirë dhe në rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr posterët nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrasa**

ZL.Anr.110/2017 më datën 03.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
Hasan Shala

***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.***